URDHËR
Nr. 305, datë 30.5.2014

PËR PROCEDURAT STANDARDE OPERACIONALE TË VEPRIMTARISË SË MBIKËQYRJES SË TREGUT, TË DETYRUESHME PËR TË GJITHA STRUKTURAT E MBIKËQYRJES SË TREGUT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 10480, datë 17.11.2012, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", i ndryshuar, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

URDHËRON:

1. Përcaktimin e procedurave standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për zbatimit e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj

PROCEDURAT STANDARDE OPERACIONALE
TË VEPRIMTARISË SË MBIKËQYRJES SË TREGUT TË DETYRUESHME PËR TË GJITHA STRUKTURAT E MBIKËQYRJES SË TREGUT

I. Fusha e veprimit dhe përkufizimi i termave

1. Ky urdhër është i detyrueshëm për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligjin e posaçëm.

2. Në këtë urdhër, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Ligji i mbikëqyrjes së tregut" është ligji nr. 10489, datë 15.12.2012, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar.

b) "Ligji i sigurisë së përgjithshme" është ligji nr. 10480, datë 17.11.2012, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore', i ndryshuar.

c) "Ligji i inspektimit" është ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

3. Termat e tjerë, të përdorur në këtë urdhër kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 10480, datë 17.11.2012, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 10489, datë 15.12.2012, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar.

II. Qëllimi dhe parimet e mbikëqyrjes të tregut

4. Qëllimi i veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut është parandalimi i shfaqjes së rreziqeve të produkteve joushqimore në shëndetin, jetën, mjedisin apo interesa të tjera publike.

5. Veprimtaria e strukturave mbikëqyrëse të tregut, udhëhiqet nga parimi i parandalimit dhe parimi i proporcionalitetit.

6. Sipas parimit të parandalimit, masat e strukturave të mbikëqyrjes së tregut, synojnë parandalimin e shfaqjes së rreziqeve të produkteve.

7. Sipas parimit të proporcionalitetit, veprimtaria e mbikëqyrjes së tregut është proporcionale në:

a) mënyrën e kryerjes të veprimeve të mbikëqyrjes;

b) në përcaktimin e masave, për parandalimin e rrezikut;

c) në përcaktimin e sanksioneve për operatorët ekonomikë përgjegjës.

8. Proporcionaliteti në kryerjen e veprimtarisë.

Në kryerjen e veprimtarisë, inspektori i strukturës së mbikëqyrjes së tregut, vepron në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në veprimtarinë e operatorit ekonomik, subjekt i inspektimit, vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit.

9. Proporcionaliteti në marrjen e masave.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr ato masa që janë:

a) të nevojshme për shmangien e rreziqeve;

b) të përshtatshme për të arritur në mënyrë efektive këtë shmangie; dhe

c) që shmangin rreziqet me sa më pak kosto për operatorët ekonomikë të përfshirë.

10. Proporcionaliteti në përcaktimin e dënimeve.

Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori i mbikëqyrjes së tregut, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion që është i nevojshëm për arritjen e qëllimit të dënimit dhe që ndërsa e arrin këtë qëllim në mënyra efektive, cenon sa më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të operatorit ekonomik.

III. Objekti i mbikëqyrjes së tregut

11. Struktura e mbikëqyrjes së tregut, brenda fushës të saj të kompetencës, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të inspektojnë, çdo produkt:

a) që është shitur, shitet apo ofrohet për shitje ose çdo konsumim apo përdorim për konsumatorët;

b) që është në zotërim ose nën kontrollin e një prodhuesi a shpërndarësi ose është i depozituar apo i shpërndarë te ndonjë person për qëllime të shitjes ose të përgatitjes për shitje, kudo që produkti të gjendet.

c) çdo produkt/instalim të vënë në shërbim/në përdorim për të tretët apo publikun e gjerë, për të cilin zbatohen rregullat dhe kërkesat e sigurisë në shërbim /përdorim, kudo që produkti gjendet.

12. Struktura e mbikëqyrjes së tregut, për produktet /grup-produktet në kompetencën e saj, ka gjithashtu të drejtën dhe përgjegjësinë për inspektimin, të:

a) Respektimit nga prodhuesi (fabrikuesi i produktit, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi i produktit dhe shpërndarësi) të detyrimeve përkatëse sipas ligjit për sigurinë e përgjithshme.

b) Respektimit nga operatorët ekonomikë (prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit, importuesi dhe /apo shpërndarësi) të detyrimeve përkatëse sipas ligjit për mbikëqyrjen e tregut dhe sipas ligjit për sigurinë e përgjithshme.

c) Respektimit nga personi përgjegjës për produktin /instalimin në shërbim të detyrimeve ligjore sipas ligjit të mbikëqyrjes të tregut.

IV. Programi dhe autorizimi i inspektimeve të mbikëqyrjes të tregut.

13. Programi dhe autorizimi i inspektimeve të mbikëqyrjes të tregut, kryhet në përputhje me ligjin për inspektimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

14. Programimi i veprimtarisë të mbikëqyrjes të tregut bazohet mbi vlerësimin e riskut.

V. Paraqitja për inspektim dhe identifikimi i inspektorit dhe personave ndihmës gjatë veprimeve të inspektimit

15. Inspektori/inspektorët e mbikëqyrjes së tregut (këtej e tutje "Inspektori"), përpara fillimit të veprimeve konkrete të inspektimit, informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për objektin e inspektimit e për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

16. Inspektori detyrohet që, nëse është e nevojshme, të informojë në çdo hap përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

17. Inspektori i mbikëqyrjes së tregut, gjatë gjithë kohës së inspektimit mban në një vend të dukshëm "kartën e inspektorit" të lëshuar nga Inspektorati Qendror për inspektorët shtetërorë apo nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore për inspektoratet vendore.

18. Sipas përcaktimit të autorizimit të inspektimit, në veprimtaritë e inspektimit mund të jenë prezent edhe persona të tjerë të përcaktuar shprehimisht në autorizimin e inspektimit. Personat e tjerë identifikohen dhe mbajnë në vend të dukshëm kartën e ndihmësit të lëshuar nga titullari i strukturës së mbikëqyrës së tregut.

VI. Metodologjia e mbikëqyrjes së tregut

19. Inspektori, për çdo produkt objekt inspektimi mund të kryejë këta tipa kontrolli:

a) kontroll dokumentar;

b) kontroll fizik tregues;

c) kontroll laboratorik.

20. Kontrolli dokumentar synon verifikimin e dokumentacionit teknik të produktit (disenjimin dhe ndërtimin e produktit) dhe dokumentacionit shoqërues të tij.

21. Kontrolli i dokumentacionit teknik të produktit përfshin, por pa u kufizuar, verifikimin e:

a) Deklaratës të konformitetit, për produktet për të cilat ka rregulla teknike të miratuara;

b) Dokumentacionit teknik për ndërtimin e produktit;

c) Raportet e testeve apo dokumente të tjera që vlerësojnë konformitetin e produktit;

22. Dokumentacioni i parashikuar në shkronjën "b" dhe "c" të paragrafit 21 më sipër, verifikohet nëse është i disponueshëm tek operatori subjekt inspektimi. Nëse konsiderohet e nevojshme inspektori kërkon paraqitjen e tij brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar prej tij.

23. Kontrolli i dokumentacionit shoqërues përfshin, por pa u kufizuar, verifikimin e:

a) udhëzimeve të përdorimit të produktit;

b) udhëzimeve të mirëmbajtjes së produktit (nëse janë të zbatueshme).

24.Kontrolli, sipas paragrafit 23, përfshin verifikimin e ekzistencës së tyre, përkthimit në gjuhën shqipe, si dhe qartësisë dhe plotësisë së tyre.

25. Kontrolli i dokumentacioni teknik, veçanërisht i deklaratës së konformitetit, është tregues i rëndësishëm për sigurinë e produktit: kur ai mungon, është i gabuar apo është kontradiktor (i referohet standardeve apo rregullave të pazbatueshme etj.) ka gjasa që produkti të mos jetë i sigurt.

26. Kontroll fizik tregues synon verifikim sipas listë-kontrollit përkatës të elementeve thelbësore të kontrollit sipas produktit/kategorisë së produktit. Listë-kontrollet për produkt apo grup-produkte hartohen dhe miratohen në bazë të parashikimeve në kreun XVIII të këtij urdhri.

27. Kontrolli fizik përfshin edhe kryerjen e testeve (provave) të thjeshta në vend, lidhur me elementet thelbësore të kontrollit të produktit. Këto lloj testesh kanë vetëm vlerë orientuese, domethënë, ato shërbejnë për të krijuar apo jo dyshimin që produkti ka mangësi dhe ato duhen interpretuar së bashku me gjetjet e tjera gjatë inspektimit.

28. Inspektori, vendos kryerjen e një "vlerësimi paraprak të riskut" dhe shtrirjen e mëtejshme të hetimit administrativ, nëse nga kontrolli dokumentar dhe kontrolli fizik:

a) Krijohet dyshimi i arsyeshëm se produkti nuk përmbush kërkesat ligjore/kërkesat e përgjithshme të sigurisë të zbatueshme për të, apo megjithëse produkti mund t'i përmbushë kërkesat ligjore/kërkesat e përgjithshme të sigurisë, ai mund të jetë i rrezikshëm;

b) Konstatohen, mangësi të qarta dhe të dukshme lidhur me elementet thelbësore të kontrollit.

29. Vlerësimi paraprak i riskut kryhet sipas procedurës të parashikuar në seksionin XX të këtij urdhri.

30. Shtrirja e hetimit administrativ përfshin marrjen e mostrave dhe kontrollin laboratorik të tyre dhe/apo kërkimin e informacionit dhe dokumentacionit shtesë mbi sigurinë e produktit.

31. Marrja dhe trajtimi i mostrave kryhet sipas procedurave të parashikuara në seksionin XIX të këtij urdhri.

VII. Masat urgjente

32. Inspektori mund të marrë, me vendim të ndërmjetëm, masat urgjente të parashikuara në këtë seksion dhe çdo masë tjetër proporcionalë që ka për qëllim parandalimin apo minimizimin e një risku.

33. Masat urgjente mund të merren në çdo moment gjatë inspektimit deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar. Regjimi juridik i tyre përcaktohet sipas ligjit për inspektimin.

34. Në rast dyshimi të arsyeshëm, kur një produkt paraqet një risk të ulët apo mesatar, inspektori vendos masën e ndalimit të furnizimit, ofrimit apo ekspozimit të produkteve apo grup-produkteve.

35. Në rast dyshimi të arsyeshëm, që një produkt paraqet një risk të lartë apo serioz, inspektori vendos masën e ndalimit të përkohshëm të tregtimit (të bërjes të disponueshëm në treg).

36. Në rastet kur konkludohet, gjatë inspektimit apo hetimit, që produkti, dukshëm (jashtë çdo dyshimi) paraqet një risk mesatar, të lartë apo serioz, inspektori vendos masën e ndalimit të përkohshëm të tregtimit (të bërjes të disponueshëm të produktit në treg).

37. Inspektori vendos masën e ndalimit të furnizimit, ofrimit apo ekspozimit të produkteve apo grup-produkteve, pavarësisht nga kategoria e riskut edhe në këto raste:

a) Produkti nuk është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar për përputhshmërinë/sigurinë e produktit, sipas

legjislacionit në fuqi;

b) Dokumentacioni i përcaktuar në shkronjën "a" nuk është i plotë, i vërtetë;

c) Produkti për të cilin kërkohet të tregtohet së bashku me udhëzimet për përdorim dhe/apo për mirëmbajtje, nuk shoqërohet me to, apo informacioni nuk është i plotë dhe në gjuhën shqipe;

d) Produkti për të cilin parashikohet markimi i konformitetit nuk e përmban këtë markim ose markimi është vendosur në mënyrë të paligjshme.

38. Në rastin e parashikuar në paragrafët 35 dhe 36, masa urgjente e parashikuar, mund të shoqërohet edhe me masën e urdhërimit të operatorit ekonomik për lajmërimin e konsumatorit dhe/ose përdoruesit të fundit, për riskun përkatës, nëse produkti është bërë tashmë i disponueshëm në treg.

39. Lajmërimi sipas paragrafit 38 më sipër, përmban lajmërimin për rrezikun e mundshëm, si dhe lajmërimin për mospërdorimin e produktit deri në një lajmërim të dytë. Lajmërimi bëhet nga operatori përgjegjës nën mbikëqyrjen e strukturës përgjegjëse.

40. Në rastin e produktit/instalimit në përdorim /shërbim, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm apo rezulton qartësi se përdorimi i produktit paraqet risk mesatar, të lartë apo serioz, inspektori vendos si masë urgjente ndalimin e përkohshëm të funksionimit apo përdorimit të produktit/instalimit.

41. Inspektori vendos masën e parashikuar në paragrafin 40 më sipër, pavarësisht nga kategoria e riskut edhe në këto raste:

a) Produkti/instalimi në shërbim/përdorim është i paregjistruar sipas kërkesës së ligjit;

b) Produkti/instalimi në shërbim/përdorim nuk i është nënshtruar inspektimit periodik sipas ligjit për periudhën përkatëse;

c) Mungon dokumentacioni për inspektimin periodik të vlefshëm për periudhën përkatëse;

d) dokumentacioni apo shënimi i inspektimit periodik të vlefshëm për periudhën përkatëse është i pavërtetë.

42. Nëse produkti/instalimi në përdorim/shërbim, dyshohet se mund të paraqesë rrezik të ulët dhe vetëm në kushte të caktuara përdorimi, struktura përgjegjëse mund të vendosë, si masë urgjente vënien e paralajmërimeve të nevojshme për parandalimin apo minimizim e rrezikut.

VIII. Përfundimi i hetimit administrativ

43. Me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar në përputhje me ligjin, inspektori/inspektorët kryejnë një hetim të plotë administrativ.

44. Hetimi administrativ përfshin, nëse është e nevojshme, kryerjen e kontrollit laboratorik dhe shqyrtimin e dokumentacionit teknik dhe atij shoqërues të produktit.

45. Gjatë hetimit, struktura përgjegjëse komunikon sa herë është e nevojshme me operatorin ekonomik përgjegjës. Komunikimi me operatorin ekonomik përgjegjës sigurohet në çdo formë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

46. Struktura e mbikëqyrjes së tregut mund t'i kërkojë operatorit përgjegjës ekonomik, dosjen /dokumentet teknike të produktit, pjesë apo përmbledhje të caktuara të tyre. Nëse është e nevojshme, dokumentacioni kërkohet i përkthyer në shqip.

IX. Vendimi përfundimtar

47. Vendimi përfundimtar merret sipas procedurave dhe brenda afateve të parashikuara në ligjin për inspektimin.

48. Vendimi përfundimtar merret nga inspektori /inspektorët që kanë kryer inspektimin pas marrjes së mendimit të Komisionit të Menaxhimit të Riskut, të krijuar sipas seksionit XXI më poshtë të këtij urdhri.

49. Vendimi përfundimtar merret në bazë të rezultateve të "vlerësimit përfundimtar të riskut", bazuar në një hetim të plotë administrativ, duke u mbështetur në gjetjet e inspektimit, verifikimin e dokumenteve përkatëse (në mënyrë të veçantë të dosjes teknike) dhe rezultatet e kontrollit laboratorik të mostrave, nëse është rasti.

50. Vendimi përfundimtar merret vetëm pasi i është dhënë mundësia e shprehjes operatorit përgjegjës sipas ligjit. Komunikimi me operatorin përgjegjës sigurohet në çdo formë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

51. Në përfundim të hetimit administrativ sipas rregullave të parashikuara në këtë seksion, inspektori përgjegjës, në bazë të kategorisë të riskut të identifikuar, mund të vendosë marrjen e njërës apo më shumë nga masat e parashikuara në seksionet X deri XVII më poshtë të këtij urdhri.

X. Paralajmërimi zyrtar

52. Paralajmërimi zyrtar është masa më pak e rreptë që mund të vendosë të marrë struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

53. Nëse në përfundim të hetimit administrativ, vlerësohet se produkti është i sigurt, por janë konstatuar shkelje të vogla të kërkesave ligjore që nuk ndikojnë në sigurinë e tij në asnjë rrethanë, me vendim përfundimtar inspektori vendos, marrjen e masës së paralajmërimit. Paralajmërimi shoqërohet me urdhërimin për ndreqjen e shkeljeve, brenda një afati të caktuar dhe të arsyeshëm të përcaktuar nga inspektori.

54. Shkelje të vogla të kërkesave ligjore, që nuk ndikojnë në sigurinë e produktit, konsiderohen kryesisht, por jo vetëm: mangësi në etiketimin lidhur me të dhënat e produktit, të të dhënave të prodhuesit, përfaqësuesit të autorizuar apo importuesit, paqartësi në udhëzimet e përdorimit apo mirëmbajtjes etj.

55. Operatori ekonomik përgjegjës, që ka marrë paralajmërim, detyrohet të korrigjojë mangësitë brenda afatit të përcaktuar dhe përpara sesa të bëhen dërgesa të mëtejshme të produktit.

56. Me përfundimin e afatit, struktura përgjegjëse duhet të verifikojë nëse mangësitë janë korrigjuar vërtet.

XI. Marrja e masave të posaçme të sigurisë

57. Në rastet që vlerësohet se produkti është i sigurt, por ai mund të paraqesë një shkallë rreziku të bartur me përdorimin e produktit në kushte të caktuara, për përdorues të caktuar apo për shkak të kushteve të tregtimit, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut mund të vendosë detyrimin e operatorit ekonomik përgjegjës:

a) të vendosë shënimin përkatës e të përshtatshëm në produkt për paralajmërime, të formuluara në gjuhën shqipe, në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, për risqet që mund të paraqesë;

b) të bëjë tregtimin e tij, në kushte të përcaktuara nga struktura e mbikëqyrjes së tregut;

c) bëjnë paralajmërime personave të caktuar, në formën e përshtatshme, përfshirë edhe publikimin e paralajmërimeve të veçanta.

58. Operatori ekonomik përgjegjës, që ka marrë paralajmërim, detyrohet të plotësojë detyrimet brenda afatit të përcaktuar.

59. Me përfundimin e afatit, struktura përgjegjëse duhet të verifikojë korrigjimin e mangësive.

XII. Ndalimi i përkohshëm i tregtimit

60. Në rastet kur vlerësohet se produkti paraqet një rrezik të çfarëdo kategorie, duke mos qenë në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë apo megjithëse në përputhje me këto kërkesa, është i rrezikshëm dhe mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjera publike, dhe kur vlerësohet se rreziku mund të shmanget, brenda një afati të arsyeshëm nëpërmjet modifikimit të produktit, struktura përgjegjëse vendos masën e ndalimit të përkohshëm të tregtimit deri në eliminimin e rrezikut.

61. Produkti, tregtimi i të cilit është ndaluar nuk mund të tregtohet dhe/apo të importohet në territorin e vendit deri në shmangien e rrezikut.

62. Produkti i modifikuar mund të tregtohet dhe/apo importohet vetëm pas miratimit me shkrim të strukturës përgjegjëse, pas një inspektimi të ri që vërteton shmangien e rrezikut.

XIII. Ndalimi i përhershëm i tregtimit

63. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, vendos ndalimin e përhershëm të tregtimit në këto raste:

a) Produkti nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë apo megjithëse në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë, është i rrezikshëm dhe mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjera publike; dhe

b) Rreziku që paraqet produkti, nuk është e mundur të shmanget, brenda një afati të arsyeshëm nëpërmjet modifikimit të tij, apo ky i fundit nuk paraqet garanci të mjaftueshme për modifikimin e përshtatshëm, të produktit.

64. Produkti, tregtimi i të cilit është ndaluar nuk mund të tregtohet apo të importohet në territorin e vendit.

65. Ndalimi i përhershëm i tregtimit vendoset nga struktura përgjegjëse, edhe në këto raste:

a) e njëjta masë është marrë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ku është tregtuar produkti;

b) prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm ose nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë.

XIV. Tërheqja e produktit nga tregu:

66. Nëse produkti që rezulton i rrezikshëm, gjendet tashmë në treg, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përveç "ndalimit të tregtimit" vendos edhe masën "tërheqje nga tregu" të produktit.

67. Masa e "tërheqjes nga tregu" merret, nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes të tregut, në rastet kur veçoritë e rrezikshme të produktit nuk konsiderohen, të jenë në atë shkallë që të kërkohet kthimi mbrapsht i tij nga konsumatorët, ose kur produkti nuk ka shkuar ende te konsumatorit.

68. Tërheqja nga tregu, në varësi të gjendjes së produktit në zinxhirin e shpërndarjes mund të jetë e këtyre formave:

a) tërheqja nga shpërndarësit;

b) tërheqja nga i gjithë zinxhiri i tregtimit;

69. Struktura përgjegjëse vendos se tërheqja është e mjaftueshme duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së produktit në kuptimin e përdorimit të tij, si dhe numrin e produkteve të shitura. Në këto raste, operatorët ekonomikë janë të lirë, ta shtrijnë këtë masë deri në kthimin mbrapsht të produktit nga të gjithë konsumatorët. Procesi i tërheqjes nga tregu mund të përfshijë një shkresë nga fabrikuesi/importuesi për tregtarët me pakicë, ku njoftohet për tërheqjen nga tregu dhe udhëzohen për mënyrën dhe organizimin e tërheqjes së produktit, si dhe trajtimin e tij për këtë qëllim.

XV. Kthimi mbrapsht i produktit nga konsumatorët

70. Nëse produkti që rezulton me risk serioz gjendet në treg, apo nëse produkti rezulton me çfarëdo kategori tjetër risku dhe ka arritur te konsumatori apo përdoruesi i fundit, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, përveç ndalimit të tregtimit vendos edhe masën e "kthimit mbrapsht të produktit nga konsumatori".

71. Me urdhërimin e kthimit mbrapsht të produktit, operatori përgjegjës duhet të kryejë sa më shpejt të jetë e mundur, kthimin mbrapsht të çdo produkti të shitur nga konsumatori apo përdoruesi final.

72. Kthimi mbrapsht i produktit nga operatori përkatës përgjegjës bëhet nën mbikëqyrjen e strukturës përgjegjëse. Nëse është e nevojshme apo i kërkohet, struktura përgjegjëse bashkërendon veprimtarinë e kthimit të produktit me prodhuesit dhe shpërndarësit.

73. Kur masat e marra nga operatori ekonomik nuk janë të mjaftueshme, apo çdo rast tjetër të nevojshëm, struktura përgjegjëse organizon drejtpërdrejt kthimin mbrapsht të produktit.

Kthimi mbrapsht i produktit sipas paragrafit 73 më sipër, kryhet me shpenzimet e operatorit ekonomik përgjegjës. Struktura përgjegjëse njofton operatorin ekonomik për shumën përkatëse që detyrohet të paguajë.

XVI. Lajmërimi publik i konsumatorit

74. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, vendos urdhërimin e lajmërimit publik të konsumatorit, sa herë që një masë e tillë është e nevojshme për shmangien e rrezikut. Në mënyrë të veçantë, lajmërimi publik i konsumatorit, vendoset së bashku me masën e tërheqjes nga tregu apo kthimit mbrapsht të produktit nga konsumatori në rastet e mëposhtme:

a) kur produkti duhet të tërhiqet dhe operatori ekonomik, njeh vetëm një pjesë të konsumatorëve;

b) kur produkti duhet të largohet nga tregu dhe parashikohet se ky produkt është kaq i lirë sa që, ka të ngjarë, që vetë përdoruesi ta heqë atë.

75. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, vendos masën e lajmërimi publik të konsumatorit, edhe veçmas (pra, jo bashkë me masën e tërheqjes nga tregu apo kthimit të produktit nga konsumatori), nëse problemet e mundshme të sigurisë, karakteristike të një rreziku të ulët, mund të zgjidhen plotësisht duke paralajmëruar konsumatorët dhe pa kërkuar modifikimin e produktit.

76. Lajmërimi publik bëhet nga operatori ekonomik përgjegjës dhe mbikëqyret nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

77. Struktura përgjegjëse mund të vendosë të kryejë drejtpërdrejt lajmërimin publik të konsumatorit në këto raste:

a) Operatori ekonomik përgjegjës nuk mund të identifikohet;

b) Masat e mara nga operatori ekonomik përgjegjës nuk janë të plota, të shpejta apo të përshtatshme;

c) rreziku që paraqet produkti, është aq i madh sa konsumatorët mund të dëmtohen rëndë nëse nuk e marrin shpejt lajmërimin përkatës;

d) Rreziku është i pranishëm për një klasë të tërë produktesh e jo vetëm për një artikull/model të caktuar.

78. Lajmërimi publik i konsumatorit duhet të jetë i plotë, i qartë, dhe të kryhet me mjete të përshtatshme dhe efektive publikimi. Mjete të përshtatshme përfshijnë njoftimin në median e shkruar dhe atë vizive.

79. Lajmërimit publik, drejtpërdrejt, sipas paragrafit 78, përveç rastit kur operatori nuk mund të identifikohet, kryhet me shpenzimet e operatorit përgjegjës. Shuma përkatëse që detyrohet të paguajë, operatori, i njoftohet me akt të veçantë nga struktura përgjegjëse.

XVII. Shkatërrimi i produktit

80. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut vendos shkatërrimin e produkteve kur ato janë kthyer mbrapsht prej konsumatorëve dhe:

a) Produkti paraqet një rrezik të tillë për sigurinë e konsumatorëve sa që duhet shkatërruar; apo

b) Është i pamundur nga operatori ekonomik përgjegjës, modifikimi apo rieksportimi i produktit .

81. Përpara marrjes së masës për shkatërrimin e produktit, struktura përgjegjëse duhet të marrë parasysh ndikimin ekonomik mbi operatorin ekonomik dhe të konsultohet, në mënyrë që të sigurojë që modifikimi apo rieksportimi i produktit nuk është i mundur.

82. Shkatërrimi i produktit bëhet nga struktura e posaçme, me shpenzimet e operatorit ekonomik përgjegjës dhe sipas proceduarve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Shuma përkatëse që detyrohet të paguajë operatori, i njoftohet me akt të veçantë të strukturës përgjegjëse.

XVIII. Listë kontrollet

83. Secila strukturë e mbikëqyrjes së tregut harton listë-kontrollet për secilin nga produktet/grup-produktet nën kompetencën e saj.

84. Listë-kontrolli hartohet nga struktura përkatëse e mbikëqyrjes së tregut dhe miratohet nga kryeinspektori, pas marrjes së mendimit këshillimor të Inspektoratit Qendror dhe ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

85. Listë-kontrolli përmban elementet thelbësore të kontrollit dhe testet e nevojshme lidhur me sigurinë e një produkti apo grupi produktesh të përcaktuara. Elementet thelbësore janë: dokumentacioni, markime, shënime apo veti/karakteristika kryesore të produktit/grup-produkteve që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e tyre).

86. Çdo listë-kontroll përmban të paktën këto elemente të detyrueshme kontrolli:

a) Markimin e produktit;

b) Emrin e prodhuesit në produkt, dhe/ose sipas rastit, përfaqësuesit të autorizuar apo importuesit;

c) Deklaratën e konformitetit/dokument tjetër ekuivalent sipas legjislacionit;

d) Dokumentet shoqëruese të produktit (udhëzimet e përdorimit dhe/ose mirëmbajtjes);

e) Kontrollimin për anë të mprehtë në vendet ku përdoruesit e prekin produktin (A ka produkti, në pjesën që preket ashkla apo të tjera si këto? A duket se produkti ka nivel të lartë rrezikshmërie për t'u djegur?);

f) Kontrollimin për nxehje shumë të produktit në vendet ku e prekin përdoruesit (qëllimisht ose jo qëllimisht).

87. Përveç elementeve të përcaktuara në paragrafin 86 më sipër, listë-kontrolli për çdo produkt/grup-produkte përmban elementet e tjera thelbësore specifike për produktin/grup-produktin përkatës.

a) Elementet specifike thelbësore dhe testet specifike të kontrollit përcaktohen në bazë të kërkesave të parashikuara në standardet e harmonizuara shqiptare dhe legjislacionin e përgjithshme apo të veçantë në fuqi për produktin.

XIX. Procedura e marrjes, trajtimit dhe kontrollit laboratorik të mostrës

88. Përveçse kur numri i mostrave parashikohet shprehimisht në standardin apo rregullin teknik përkatës, si rregull për kontroll laboratorik merren tre mostra identike të produktit pjesë e së njëjtës parti.

89. Për mostrat e marra, inspektori i lëshon subjektit të inspektimit një "vërtetim mostre". Vërtetimi përmban të dhënat e përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

90. Vërtetimi i marrjes të mostrës përpilohet 1 në origjinal dhe 2 kopje identike. Origjinali i vërtetimit dhe një nga kopjet mbahet nga struktura mbikëqyrëse dhe është pjesë përbërëse e dosjes së procedimit përkatës. Kopja e fundit i njoftohet prodhuesit/importuesit/tregtuesit me pakicë në mjediset e tij.

91. Vendimi procedural për marrjen e mostrave, pasqyrohet, gjithashtu, në procesverbalin e inspektimit.

92. Produkti i marrë mostër, ruhet në ambalazhin fillestar apo ambalazhohet në mënyrë të tillë që të mos cenohet integriteti dhe siguria e produktit. Kur produktet nuk janë të reja (domethënë të marra drejtpërdrejt nga zinxhiri i shitjeve) dhe sidomos kur ato hetohen si pjesë e një çështjeje gjyqësore, do t'i kushtohet vëmendje e posaçme ambalazhimit të produktit në mënyrë të tillë që vetë produkti të mos ndryshojë.

93. Tre mostrat e marra ndahen në mënyrë rastësore në:

a) mostra kryesore (K) për kontroll laboratorik;

b) mostra rezerve (A), që mbahet nëse mostra e parë del se ka mangësi të rrezikshme dhe

c) mostra e referencës (R), që mbahet, për rastet e mosmarrëveshjeve gjyqësore me operatorin.

94. Secila nga tre mostrat e marra etiketohet në mënyrë të përshtatshme. Etiketimi përmban një numër unik identifikimi të mostrës dhe kategorisë së mostrës (mostra kryesore (K), mostra rezervë (A), mostra e referencës (R)).

95. Numri unik i identifikimit është pjesë e një regjistri të mostrave të krijuar nga struktura përgjegjëse. Në regjistrin përkatës numri unik i identifikimit lidhet me numrin e procedimit administrativ, që është numri i dosjes së procedimit në fjalë.

96. Mostra kryesore (K) dërgohet në laborator, ndërsa dy mostrat e tjera, të shoqëruara me kojen e dytë të vërtetimit, ruhen në ambiente të përshtatshme për këtë qëllim në strukturën e mbikëqyrjes së tregut.

97. Mostra kryesore dërgohet në një laborator të akreditуar sipas kësaj radhe preference:

a) laboratorët e strukturës së mbikëqyrjes të tregut;

b) laboratorë të tjerë shtetërore; apo

c) laboratorë privatë të akredituar për këtë qëllim.

98. Gjatë kryerjes së testeve, laboratori mund të vendosë, gjithashtu, numrin e vet unik të identifikimit për produktin.

99. Laboratori përqendrohet vetëm në testimin e karakteristikave/vetive për të cilat produkti është ose jo në përputhje me standardet. Gjetjet përmblidhen në Raportin e Testimit, që mbahet në tri kopje. Një nga kopjet mbahet në laborator, ndërsa tjetra bëhet pjesë e dosjes të procedimit përkatës.

100. Raporti i Testimit përshkruan vetitë/ karakteristikat për të cilat produkti është ose jo në përputhje me kërkesat e sigurisë. Raporti i testimit nuk vlerëson nëse këto mospërputhje janë të rrezikshme apo jo.

XX. Vlerësimi i riskut

101. Inspektori/inspektorët përgjegjës kryejnë vlerësimin paraprak apo përfundimtar të riskut për çdo veti/karakteristikë të produktit që lidhet me sigurinë e tij sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës. Vlerësimi i riskut përfshin këta komponentë:

a) rëndësinë/gravitetin e dëmit;

b) probabilitetin e prodhimit të dëmit.

102. Në bazë të rezultatit për çdo veti/karakteristikë, hartohet vlerësimi i përgjithshëm i riskut të produktit sipas njërës prej këtyre kategorive:

a) risk i ulët;

b) risk i mesëm;

c) risk i lartë;

d) risk serioz.

103. Vlerësimi i riskut për çdo veti/karakteristikë dhe vlerësimi i përgjithshëm risku për produktin kryhet bazuar në udhëzimin e ministrit nr. 177, datë 26.12.2013 dhe sipas aneksit 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

XXI. Komisioni i Menaxhimit të Riskut

104. Në çdo strukturë të mbikëqyrjes së tregut funksion Komisioni i Menaxhimit të Riskut. Komisioni i Menaxhimit të Riskut jep mendim këshillimor për masat e nevojshme që duhen marrë me vendim përfundimtar. Me kërkesë dhe nëse është e mundur Komisioni i Menaxhimit të Riskut jep mendim këshillimor edhe për masat urgjente.

105. Komisioni i Menaxhimit të Riskut është komision *ad hoc* që krijohet nga titullari strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut. Komisioni *ad hoc* përbëhet nga titullari i strukturës përgjegjës dhe nëpunës të njësive organizative përbërëse të strukturës përgjegjëse.

106. Komisioni i Menaxhimit të Riskut ka një numër tek anëtarësh, jo më të vogël se pesë.

Aneksi 1: Vërtetimi i marrjes së mostrës

Nr. ref. i mostrës_____ Data: _____ Emri / Vendndodhja e pikës së tregtimit: _____ Përshkrimi i produktit: _____ Importuar nga (specifiko vendin): _____ Prodhuar në vend:_____ Marka(t) Emërtimi (et)/Emri i prodhuesit: Pesha/Sasia e mostrave të marra: _____ Loti/partia nr.: _____ Nënshkrimi i zotëruesit/ Emri me shkronja të mëdha të zeza: _____ Numri i telefonit:_____ Nënshkrimi i inspektorit të mbikëqyrjes së tregut / Emri me shkronja të mëdha të zeza: _____ [Drejtuar dhe për llogari të strukturës së mbikëqyrjes së tregut] Mostra e kthyer më: _____ Nënshkrimi i pronarit për pranimin:_____

Aneks nr. 2. Formulari i vlerësimit të riskut

FORMULARI I VLERËSIMIT TË RISKUT		
Data:	Produkti:	Inspektori:

A. Vlerësimi i shkallës së dëmtimit

Niveli 1: Dëmtimi ose pasoja që pas ndihmës së parë, normalisht jo me një mjek, nuk dëmton në thelb aftësitë funksionale të individit ose nuk shkakton dhimbje të tepërt; në këto raste pasojat janë zakonisht krejtësisht të kthyeshme	**Niveli 2:** Dëmtimi ose pasoja për të cilën është e nevojshme vizita në institucionet shëndetësore,përfshirë Shërbimin e Urgjencës, por për të cilën përgjithësisht nuk nevojitet shtrimi në spital. Në këto raste mund të preken aftësitë funksionale për një periudhë të kufizuar, por jo më shumë se 6 muaj, dhe shërimi është pak a shumë i plotë.	**Niveli 3**: Dëmtimi ose pasoja që normalisht kërkon shtrimin në spital dhe ndikon në aftësitë funksionale të individit për më shumë se 6 muaj ose çon në humbje të përhershme të funksionit	**Niveli 4:** Dëmtimi ose pasoja që është ose mund të jetë fatale, duke përfshirë mosfunksionimin etrurit; pasoja që ndikojnë në riprodhimin ose pasardhësin, humbje të rënda të gjymtyrëve dhe/ose funksionit, që çon në më shumë se rreth 10% të kufizimit të aftësisë
<2% paaftësim, zakonisht e kthyeshme e që nuk kërkon kurim në spital	**2 – 10% paaftësim, zakonisht i pakthyeshëm e që kërkon kurim në spital**	**>10% paaftësim**	**>20% paaftësim, zakonisht i pakthyeshëm**
			Vdekje
Prerje të vogla	Prerje të rënda	Prerje e organeve të brendshme	Dëmtim serioz i organeve të brendshme
Fraktura të lehta	Humbje e gishtit të dorës apo të këmbës	Thyerje e kockës	Humbje e gjymtyrëve
	Dëmtim i shikimit	Humbje e pjesshme e shikimit	Humbje e shikimit

Nxjerrje nga vendi e gjymtyrëve	Dëmtim i dëgjimit	Humbje e pjesshme e dëgjimit	Humbje e dëgjimit
Djegie të lehta	Djegie mesatare	2º, 16-35 % e sipërfaqes së trupit, ose 3º, deri në 35 % të sipërfaqes së trupit Djegie nga thithja	2º ose 3º, > 35 % e sipërfaqes së trupit Djegie nga thithja që kërkon asistim të frymëmarrjes
Ndrydhje	Paaftësi mesatare	Këputje e muskulit	Paaftësi e rëndë e përhershme

B) Probabiliteti i përgjithshëm i dëmtimit të shëndetit/sigurisë

Probabiliteti i dëmtimit të produktit	
Pothuajse e sigurt, pritet të ndodhë	> 50%
Tërësisht e mundur	> 1/10
E pazakontë, por e mundur të ndodhë	>1/100
Pak e mundur të ndodhë	>1/1 000
E imagjinueshme, por shumë e vështirë të ndodhë	>1/10 000
Praktikisht e pamundur të ndodhë	>1/ 100 000
E pamundur të ndodhë	>1/1 000 000
Virtualisht e pamundur të ndodhë	<1/1 000 000

C) Vlerësimi i përgjithshëm i riskut

Probabiliteti i dëmtimit të produktit		**Shkalla e dëmtimit**			
Pothuajse e sigurt, pritet të ndodhë	> 50%	**H**	**S**	**S**	**S**
Tërësisht e mundur	> 1/10	**M**	**S**	**S**	**S**
E pazakontë por e mundur të ndodhë	>1/100	**M**	**S**	**S**	**S**
Pak e mundur të ndodhë	>1/1 000	**L**	**H**	**S**	**S**
E imagjinueshme, por shumë e vështirë të ndodhë	>1/10 000	**L**	**M**	**H**	**S**
Praktikisht e pamundur të ndodhë	>1/ 100 000	**L**	**L**	**M**	**H**
E pamundur të ndodhë	>1/1 000 000	**L**	**L**	**L**	**M**
Virtualisht e pamundur të ndodhë	<1/1 000 000	**L**	**L**	**L**	**L**

S – risk serioz
H – risk i lartë
M – risk mesatar
L – risk i ulët